

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe me sekretaren juridike Vildane Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Xh. nga Vushtëri, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 nënpar. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Komunale në Ferizaj, PP.nr.1615/2010 të dt. 02.06.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Veton Shabani, të pandehurit E.Xh., me datë 15 Korrik 2016 mori dhe publikisht komunikoi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: E.Xh. data e lindjesi....., nga i ati E. dhe nëna B. e gjinisë A..., me vendbanim në Vushtrri, Rr. “.....”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.07.2010, rrethe orës 11:00, në Rr.”Besim Fazliu” në Ferizaj, në shtëpinë e të dëmtuarit D.R., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetës t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me përdorimin e forcës, ka hapur njërën nga dritaret e shtëpisë, ka depërtuar brenda dhe nga aty ka marrë: 10 pllaka të arit, 3 palë vath të arit, 1 kamerë digjitale “Canon”, para kesh 360 €, ku dëmi i përgjithshëm i sendeve të vjedhura sillet 2760 € dhe largohet nga vendngjarja pa u vërejtur nga askush.

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 nënpar.1 të KPK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 253 par. 1 nënpar.1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 49, 51, 73 dhe 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

D Ë N I M M E B U R G

- Të pandehurin i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje 7 /shtatë/ Muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.
- I dëmtuari, D.R. nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore -juridike udhezohet ne kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Ish- Prokuroria Komunale në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshem, me aktakuzën të evidentuar PP.nr.1615/2010 të dt. 02.06.2011, ka ngarkuar të pandehurin E.Xh., për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nënpar.1 të KPK-së, dhe ne shqyrtim gjyqësor ka propozuar qe te i shqiptojë sanksion penal te parapar me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 15.07.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshëm. I pandehuri E.Xh. ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: pranoj fajsinë për veprat penale vjedhje ne e rendë të cilën me ngarkon akuza, shprehui pendimi për veprën penale të

kryer, si dhe kërkoj falje publike, si dhe i premtoj Gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre, duke marre parasysh gjendjes time ekonomike i propozoj gjykatës te me shqiptoj një dënim te kushtëzuar dhe te ma japi shancen te punoj dhe te largohem nga këto dukuri negative pasi para dy muaje kam kryer vuajtjen e dënimit per disa vepra dhe kam kuptuar qe nuk ja vlen te beshe këto vepra.

Prokurori i Shtetit Veton Shabani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor për aktakuzë ne fjalë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë shqyrtimit fillestar, mendimi i ekspertit të daktiloskopisë me nr. AFF-...-.. e dt. 30.08.2010, deklarata e të dëmtuarit D.R. e dt.03.07.2010, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes e dt. 03.07.2010, pjesërisht deklarata e Xh.H. e dt.12.09.2012 dhe B.L. e dt.15.09.2012, si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mblledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit te parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave te marra në gjykim te kësaj çështje, Gjykata çmon se me veprimin e tij, te kundërligjshëm i cili ka prekur drejtpërdrejt pasurinë e huaj pronë e luajtshme te te dëmtuarit D.R. pra te drejtën e pronësisë se saj te mbrojtur nga legjislacioni penal, i pandehuri E.Xh. ka konsumuar veprën penale vjedhjes e rendë nga neni 253 par. 1 nenpar. 1 të KPK-së.

Konkretisht, sa i përket objektit të veprës penale, veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri E.Xh. kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen dhe paprekshmërisë e pronës dhe të drejtave pasurore të personave fizike e juridike nga veprimet kriminale të mbrojtura nga legjislacioni ynë penal, dhe si të tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Nga ana objektive, kjo vepër është kryer nga i pandehuri E.Xh., me veprime aktive të kundërligjshme, duke hyre në shtëpi fshehurazi me përdorimin e forcës ka hapur njërën nga dritaret e shtëpisë të të dëmtuarit dhe kalon në mbrendi të shtëpisë ku nga aty merr 10 pllaka të arit, 3 palë vath të arit, 1 kamerë digjitale “Canon”, para kesh 360 €.

Nga ana subjektive këto veprime janë kryer nga i pandehuri E.Xh. dhe me dashje direkte dhe me qëllimin të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, pasi i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç’ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës të cilat janë në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e rendë nga neni 253 par. 1 nenpar. 1 të KPK-së, meqë me datat, vendet dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin të këtij aktgjykimi i akuzuari me dashje direkte ka konsumuar elementet e veprave penale të lartshënuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese, përkatësisht që në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, rrethana

lehtësuese pendimin e thelle për veprën penale të kryer, premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, i papune dhe i gjendjes se varfër ekonomiket, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se te akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale kane bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe me autoret të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I
PËRGJITHRSHËM, P.nr.217/2013, me datë 15.07.2016.**

**Sekretare Juridike,
Vildane Azemi**

**Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Ferizaj.